

# Lejet e ndërtimit


## Tremujori III, 2023

**Tiranë, më 24 Nëntor 2023:** Në tremujorin e tretë 2023 janë miratuar gjithsej 361 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 269 leje të miratuara në tremujorin e tretë 2022, duke shënuar një rritje prej 34,2 % (tab.2).

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e tretë 2023, është 455.181 m<sup>2</sup>, nga 418.685 m<sup>2</sup> miratuar në tremujorin e tretë 2022, duke shënuar një rritje prej 8,7 % (tab.3).

Në tremujorin e tretë 2023, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 18,9 miliardë lekë, nga 21,6 miliardë lekë miratuar në tremujorin e tretë 2022, duke shënuar një ulje prej 12,5 % (tab.4)

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, T3 - 2023



**Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T3 - 2023**

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
<b>Gjithsej</b>			<b>16.771.260</b>	<b>2.159.372</b>
<b>I. Ndërtesa</b>	<b>361</b>	<b>455.181</b>	<b>16.292.714</b>	<b>1.600.194</b>
1.Ndërtime për banim (rezidente)	289	314.180	12.147.773	600.741
a. Me një kat	137	13.502	436.318	80.006
b. Me dy kate	99	23.057	790.872	81.653
c. Me tre ose më shumë kate	41	179.099	7.780.257	439.082
d. Rezidenca për komunitetet	12	98.522	3.140.326	0
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	72	141.001	4.144.941	999.453
a. Hotele dhe të ngjashme	14	10.383	422.028	34.714
b. Ndërtesa për zyra	0	0	0	0
c. Ndërtesa tregtare	20	29.759	1.008.986	70.518
d. Ndërtesa industriale	24	89.051	2.414.988	259.263
e. Ndërtesa të tjera	14	11.808	298.939	634.958
<b>II. Punime inxhinierike</b>			<b>478.546</b>	<b>559.178</b>
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			60.058	443.313
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			130.200	0
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	44.999
4. Punime të tjera inxhinierike			288.288	70.866

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

\* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

**Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja**

Qarqet	III - 22	IV - 22	I - 23	II - 23	III - 23
<b>Shqipëria</b>	<b>269</b>	<b>415</b>	<b>429</b>	<b>509</b>	<b>361</b>
Berat	16	5	4	5	14
Dibër	4	3	2	4	3
Durrës	82	189	191	156	125
Elbasan	16	23	31	31	18
Fier	13	22	16	22	14
Gjirokastër	5	1	3	6	3
Korçë	20	34	38	42	43
Kukës	0	0	3	3	4
Lezhë	17	21	33	30	16
Shkodër	7	5	14	17	9
Tiranë	86	89	79	138	100
Vlorë	3	23	15	55	12

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

\* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	III - 22	IV - 22	I - 23	II - 23	III - 23
<b>Shqipëria</b>	<b>418.685</b>	<b>555.779</b>	<b>415.842</b>	<b>652.136</b>	<b>455.181</b>
Berat	12.165	867	427	1.077	3.798
Dibër	690	1.632	1.469	1.978	1.958
Durrës	96.822	79.491	102.539	74.973	67.719
Elbasan	7.031	15.688	13.192	16.150	6.426
Fier	2.259	9.891	19.093	8.222	6.574
Gjirokastër	5.263	109	872	990	394
Korçë	3.869	24.955	12.207	10.826	22.622
Kukës	0	0	750	1.402	767
Lezhë	13.338	12.926	8.445	6.494	3.355
Shkodër	1.587	7.454	5.263	8.792	2.385
Tiranë	271.611	348.310	199.580	460.872	327.930
Vlorë	4.050	54.456	52.005	60.360	11.253

Burimi: Bashkitë, llogaritjet INSTAT

\* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	III - 22	IV - 22	I - 23	II - 23	III - 23
<b>Shqipëria</b>	<b>21.633.005</b>	<b>26.572.383</b>	<b>20.967.072</b>	<b>24.407.672</b>	<b>18.930.632</b>
Berat	594.785	257.249	138.428	108.760	377.074
Dibër	14.706	1.342.625	488.955	161.577	157.802
Durrës	5.784.690	2.691.797	3.659.070	1.974.254	3.252.489
Elbasan	2.749.309	3.830.507	1.312.126	883.773	268.445
Fier	752.573	816.833	625.861	826.504	461.810
Gjirokastër	76.029	12.170	250.620	255.450	74.786
Korçë	190.842	1.451.995	398.490	491.155	907.488
Kukës	0	11.936	212.265	259.170	47.493
Lezhë	1.642.418	909.183	488.218	233.245	132.372
Shkodër	42.606	253.444	186.017	77.750	225.448
Tiranë	9.380.465	12.156.725	6.564.046	16.072.582	12.189.452
Vlorë	404.582	2.837.919	6.642.976	3.063.452	835.973

Burimi: Bashkitë, llogaritjet INSTAT

\* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

# Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

## Përkufizime

**Leja e ndërtimit** është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

**Ndërtesat** janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

**Sipërfaqja** është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

**Punime inxhinierike** janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

**Klienti** është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

## Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.